

Jeta studentore në Barlet



magazine

2nd Edition

Mësojmë të shkuarën,
Jetojmë të tashmen,
Punojmë për të ardhmen...

FAKULTETE, DEPARTAMENTE DHE PROGRAME

FAKULTETI I EKONOMISË QEVERISJES DHE DREJTËSISË

Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës

BA Financë-Kontabilitet
BA Menaxhim Biznesi
BA Financë, Bankë, Sigurime dhe Pasuri të Paluajtshme
BA Marketing, Publicitet dhe Marrëdhënie me Publikun
MP Administrim Biznesi me profil "Financë Kontabilitet"
MP Administrim Biznesi me profil "Marketing dhe Menaxhim Operacionesh"
MP Administrim Biznesi me profil "Leadership dhe Menaxhim Burimesh Njerëzore"
MSH Kontabilitet - Financë me profil "Kontabilitet"
DP Teknik në Operacione Biznesi, Marketing dhe Shitje

Departamenti i Drejtësisë

MSH Drejtësi
MSH Shkenca Juridike me profil "E Drejtë Penale dhe Kriminologji"
MSH Shkenca Juridike me profil "E Drejtë Tregtare"
MP Shkenca Juridike me profil "E drejtë e Biznesit"

Departamenti i Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikim

BA Shkenca Politike
BA Shkenca Politike me profil "Administrim Publik"
BA Shkenca Politike me profil: "Administrim Publik" & "Marrëdhënie Ndërkombëtare"
MSH Studime Europiane me profil "Politikat Europiane dhe Administrim Publik"
MP në Shkenca Politike me profil "Administrim Publik"

FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA DHE INDUSTRIVE TE APLIKUARA

Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike

BA Informatikë e Aplikuar
MP Menaxhim i Teknologjisë së Informacionit
Diplomë Profesionale në Teknik për Pajisje Elektronike dhe për TIK
Diplomë Profesionale në Teknik në Prodhime Digjitale dhe Softweri

Departamenti i Shkencave të Aplikuara dhe Industrive Kreative

MSH Arkitekturë

FAKULTETE, DEPARTAMENTE DHE PROGRAME

FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE, TURIZMIT DHE SPORTIT

Departamenti i Edukimit Fizik dhe Sporteve

BA Edukim Fizik dhe Sporte
MP Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte
MSH Mësuesi në Edukim Fizik dhe Sporte

Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekrecionit

BA Menaxhim në Turizëm, Rekreacion dhe Evente
MP Menaxhim në Turizëm, Mikpritje dhe Aktivitete Çlodhëse me profil "Turizëm dhe Udhëtime"
Diplomë Profesionale në Operator në Udhëtim, Turizëm dhe Hoteleri
Diplomë Profesionale në Operator në Fitness, Palestër dhe Organizime Eventesh Publike

Departamenti i Shkencave të Sjelljes dhe

BA Psikologji
BA Punë Sociale
MSH Psikologji Shkollore dhe Zhvillimi
Diplomë Profesionale në Operator dhe Këshillues në Përkujdesje Shëndetësore

Departamenti i Shkencave të Edukimit dhe Trajnimit Profesional

MP Edukim me profil: Mësimdhënie dhe të Nxënit

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE

Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike

BA në Infermieri
BA në Fizioterapi

Departamenti i Shkencave Mjekësore dhe të Shëndetit

MSH Farmaci

PËRMBAJTJA

- Një ditë në Barlet me Megin dhe Xhesin
- Pse në Barlet
- Krenar për Barletasit
- Njihuni me Senatorët e Qeverisë Studentore
- Studentët flasin
- Klubet Studentore
- Aktivitete në Barlet
- Shqipëria, një vend për tu eksploruar!
- Krijimtari
- Barletasit në të Ardhmen
- Çfarë e dallon qendrën YouthAct nga gjithë të tjerët?

Prof. Dr. Artan Shyti
Zv/Rektor për Çështjet
Studentore dhe Komunitetin



Të dashur Barletas,

Kam kënaqësinë e veçantë që t'ju përshëndes në këtë numër të dytë të revistës "UniBA Magazinë". Si një ide dhe realizim i studentëve të Barletit, kjo revistë është mënyra më efektive dhe e sigurtë për të pasqyruar jetën dhe aktivitetin e Universitetit Barleti nga këndvështrimi i atyre që janë objekt dhe subjekt i punës dhe impenjimit të të gjithë stafit akademik dhe administrativ të këtij institucioni.

Edhe nëpërmjet kësaj reviste studentët tanë demonstron vlerat dhe performancën e tyre duke treguar perceptimet, emocionet dhe vlerësimet e tyre për jetën studentore në të gjithë gamën e saj komplekse si vendi ku marrin dije por edhe ku ndërtojnë marrdhënie shoqërore e profesionale që do të jenë të dobishme për gjithë jetën. Bazuar në suksesin e numrit të parë të "UniBa Magazinë" jam i sigurt se edhe ky numër i dytë do të jetë po aq i vlefshëm dhe cilësor.

Lexim te këndshëm!

NJË DITË NË BARLET ME MEGIN & XHESIN

Doni të shuani kureshtjen me ne? Ne jemi dy vajza shumë të ndryshme nga njëra-tjetra kështu që eksperiencia që do t'ju përcjellim kalon përtej dy dinamike.



Dita jonë nis në 8:20 am, në vend-takimin tonë "Dumre-ja". Pas një sprinti për në shkollë, hyjmë me një buzëqeshje në leksion, sikur asgjë nuk ka ndodhur. Ah! se harruam t'ju themi, ne jemi studente në "Marketing" dhe orën e parë kemi me zysh Semin.



Leksioni ka nisur dhe vëmendja shpërndahet kur Xhesi nxjerr smoothien e saj me proteina dhe Megi nuk mund të rrijë pa e provuar e vlerësuar. Pasi kemi marr dhe proteinat, jemi gati të shpërndajmë energji kështu që kërkojmë një pushim të shkurtër.



Përshëndesim çdo njeri që kalon dhe pa e kuptuar jemi tek "Taranda" të ulura në një tavolinë të mbushur me studentë.

I mësuam të rehat e ditës, kthehem për në seminar ku mbizotëron heshtja, e cila thyhet kur përzgjidhen numrat që do të pyeten. Fatmirësisht sot nuk ishte rradha jonë, por megjithatë ne nuk mund të qendrojmë pa u përfshirë.

Diskutimi fillon gjithmonë sepse ne nuk biem dot

në një mendje, por nëse përfshihet grupi i Financës ne menjëherë i rikthehem njëra-tjetrës. as një seminari të suksesesshëm, nxitojmë tek "Teatri" sepse do të shfaqet filmi që është realizuar nga Klubi i Artit dhe Kulturës.



Çdo ditë në "Barlet" ka aktivitete nga më të ndryshmet dhe ne mundohemi të bindim njëra-tjetrën se kë do të zgjedhim.

Por gjithsesi diskutojmë më kot, sepse Xhesi duhet të zhduket bashkë me çanten e palestrës pak përpara se të mbarojë aktiviteti.

Pak më vonë ribashkohemi dhe njëherë te biblioteka për të punuar me projektet dhe detyrat e së nesërme. Kështu i vendosim pikën dhe një ditë të frytshme në "Barlet" dhe i kthehem jetës sonë të përditshme.



Shpresojmë t'ju ketë pëlqyer dhe artikulli ynë, nga këndvështrimi i dy Barletasve. Mbase duhet t'ju themi se në Barlet asnjë ditë nuk është asnjëherë njëlloj dhe ne jemi dëshmia më e mirë e kësaj të fundit!



PSE NË BARLET?

FAKULTETI I EKONOMISË QEVERISJES DHE DREJTËSISË



IRIS ASA

Marketing, Publicitet dhe Marrëdhënie me Publikun, viti III

Eksperiencia ime universitare në Barlet më ka mundësuar të zhvilloj më tej njohuritë, aftësitë dhe vetbesimin tim duke më ndihmuar në mënyrë të tillë që të përmirësoj jetën time. Të qenurit Barletas më ka hapur shumë dyer drejt mundësive të reja dhe më ka dhënë aftësitë e duhura për të marrë në kontroll fatin e të ardhmes time. Nëse do kisha mundësi të rikthehesha pas në kohë, do të kisha zgjedhur pa asnjë dyshim sërish Barletin, sepse Barleti nuk është thjesht një universitet, por është një familje e madhe që na përfshin të gjithë ne.



ORLANDO BRAHIMI

Marketing, Publicitet dhe Marrëdhënie me Publikun, viti III

Arsyeja pse zgjedha të studioj në Barlet është për mundësitë e shumta që të krijohen në fokus studentin, stafi akademik ekselent dhe mundësitë e shumta për punësim, mundësuar nga Universiteti. E rekomandoj këtë universitet për çdo maturant që ka dëshirën dhe ambicien për një formim sa më të mirë dhe arritjen e suksesit.



MEDEA AVDULI

Drejtësi, viti I

Në Barlet, sepse pikërisht ky është vendi i duhur për tu rritur dhe formuar akademikisht. Barleti është ai vend ku ne mësojmë, argëtohem dhe ndihemi komod, ndaj kjo e bën jetën studentore akoma më të bukur. Bashkëpunimi, mirëkuptimi në grup, por dhe mikpritja janë një nga pikat më të forta. Të formohemi dhe të rritemi sëbashku është një proces i gjatë i cili kërkon bashkëpunim, durim dhe shumë përkushtim, por kur e gjithë kjo bëhet sëbashku është shumë herë më e bukur dhe më e lehtë. Ja pse në Barlet, sepse komoditeti, argëtimi zhvillimi janë prioritet.



HAJDI ESTREFI

Menaxhim Biznesi, viti I

Zgjedhja për të rinisur një program të dytë studimi në "Universitetin Barleti" nuk ishte një rastësi.

Duke qenë se e kam përfunduar tashmë një program universitar, dëshira për të rinisur një të dytë ishte e madhe dhe si rrjedhojë nuk mund ta nisja kudo. Padyshim që më është dashur të hulumtoj mbi universitete të ndryshme dhe zgjedha "Universitetin e Sipërmarrjes", sepse krahas programit që unë dëshiroja, kishte edhe një jetë të pasur studentore.

Mundësitë e ndryshme dhe të shumta që Barleti i ofron studentëve të tij janë për mua një detaj tepër i rëndësishëm.

Jam e lumtur që zgjedha të studioj "Menaxhim Biznesi" në Barlet, sepse që në javët e para të studimeve vura re profesionalizmin dhe përkushtimin e stafit akademik dhe administrativ.

Rrugëtimi im sapo ka filluar....



ELISA MUÇAJ

Menaxhim Biznesi, viti III

Sapo e mbarova shkollën e mesme, dilema më e madhe ishte përgjedhja e Universitetit. Zgjedhja më e mirë që kam bërë ishte vazhdimi i studimeve të larta në "Universitetin Barleti". Këtu përveçse përkushtimit të pedagogëve në mësimdhënie dhe angazhimin e stafit që studenti të jetë primar, gjithashtu jep dhe një shërbim të veçantë që siguron punësimin tonë. Si anëtare e zyrës së karrierës pothuajse çdo ditë më vijnë njoftime nga kompani të ndryshme për punësim në fushën time. Unë jam në bachelor viti i tretë menaxhim biznesi dhe si e tillë duhet të kryej një kurs trajnimi në fushën time, përveçse zgjedhjes së lirë në ndonjë zyrë ose kompani, kam mundësinë e kryerjes së këtij trajnimi në universitet. Këtu unë mund të gjej pafund rrugë për të ardhmen time!



FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE, TURIZMIT DHE SPORTIT



FLORIAN RRAJA
Edukim Fizik dhe Sporte,
viti I

Unë jam Floriani! Të studioja për sporte ishte ëndrra ime, por vendi se ku do e realizoja këtë ëndërr më mundi derisa gjeta veten pranë Barletit. Dëshira ime tanimë u bashkëlidh me profesionalizmin e Barletit ku fokusi i tyre është studenti.

Tani kam mësuar se çfarë do të thotë arsimim, sesi është të kesh mbështetje për të arritur atë që do dhe jam i bindur që ky investim do ja vlejë gjithmonë.

Fundja, mënyra më e mirë për të parashikuar të ardhmen tonë është ta krijojmë atë apo jo? E ku me mirë se te Barletit!



MEGIANA DODA
Punë -Sociale, viti I

Në kërkim të një universiteti për të studiuar e gjeta veten në mes të familjes Barletase. Universiteti Barleti, një ndër universitetet më të mira dhe me një staf të kualifikuar dhe i akredituar maksimalisht. Në Barlet kuptova që kisha ende shumë gjëra për të mësuar dhe shumë miq për të takuar. Ashtu sikurse citon Mark Twain "Miq të mirë, libra të mirë dhe një ndër-gjegje të pastër: kjo është jeta ideale". Të gjitha këto i gjeta në Barlet.



LAURA REXHEPI
Punë Sociale, viti III

Zgjedhja për programin e studimit "Punë Sociale" ishte një dëshirë e imja, zgjedhja e "Universitetit Barleti" ishte intuitë! Stafi akademik i kualifikuar dhe i mrekullueshëm, kombinimi i dijeve teorike me aftësi konkrete, aftësia për të zbatuar në praktikë konceptet teorike abstrakte, dhe zhvillimi i trajnimeve të ndryshme, janë mundësitë që universiteti na ofron për sukses në të ardhmen. Universiteti Barleti na ofron gjithashtu eksperiencën të tjera, të tilla si, përfshirje dhe angazhim në qeverinë studentore, të qenurit pjesë apo koordinatorë të klubeve studentore, si dhe pjesëmarrjen në aktivitete me tematika dhe të ftuar të fushave të ndryshme. Barleti na ofron jo vetëm zhvillim akademik, por edhe zhvillim personal e qytetar. Të gjitha këto i gjeta përgjatë 3 viteve të studimit. Intuita ime për zgjedhjen e Universitetit Barleti nuk gaboi. Krenare që jam Barletase!



KLODETA GORREJA
Edukim Fizik dhe Sporte
viti I

Mikëpritja, kultura, sinqeriteti, dhe mësimdhënia e bëjnë një Universitet të denjë për tu bërë pjesë e tij. Zgjedhja "Universitetin Barleti" për të krijuar të ardhmen time dhe ëndrrën time po e kthej në realitet. T'iu besosh të ardhmen tënde dikujt nuk është e lehtë, por unë i besoj UniBa dhe kam besim se do ndihem krenare për punën dhe vlerat që do arrij në fund.



KRISTINA GJYLA
Punë sociale, viti III

Kohët e fundit pas ndodhjeve si tërmeti, covid-19 rëndësia e shëndetit mendor është rikthyer në vëmendjen e të gjithë njerëzve në mbarë botën. Kjo ka qenë dhe dëshira ime kur isha maturante dhe "Universiteti Barleti" ishte i vetmi universitet privat, i cili në programet e tij të studimit përfshinte degën e Punës- Sociale. Tani mbas 3 vitesh studimi jam e lumtur që jam pjesë e Barletit duke pasur mundësinë për të marrë njohuri nga një staf i kualifikuar, të cilët kanë arritur të bëjnë prej tre vitesh një kombinim perfekt të njohurive teorike dhe ato praktike. Universiteti Barleti ka në fokus zhvillimin e një jete të larmishme studentore, në të cilën ne zhvillojmë aftësi të reja, socializim me njëri tjetrin, argëtim duke na larguar lodhjen e mësimëve etj. Krenare që jam Barletase!



BLEDAR MALI
Edukim Fizik dhe Sporte, viti II

Unë jam Bledar Mali ose siç më njihni ndryshe në rrjetet sociale si "Kallini". Të jesh student është një gjë e madhe dhe të jesh student i Barletit është akoma më e madhe. Stafi, infrastruktura, jeta studentore dhe të gjitha detajet e këtij universiteti krijojnë një mjedis ku çdokush shpalos talentin e tij dhe një më mirë vetveten.

Jam krenar për zgjedhjen time dhe shumë më i motivuar për të nesërmen!
"E nesërmeja na pret, sot vendosim.."



BESJANA BEQIRI
MP Edukim Fizik
dhe Sport, viti III

Zgjedhja Barletin pasi kisha dëgjuar për mënyrën e studimit, për jetën studentore që ofron, për aktivitetet e shumta, për mundësitë e reja që të shfaqen.

Jam shumë e lumtur që jam studente e një stafi të kualifikuar pedagogësh, ku nuk gjej limite për tu shprehur, ku Universiteti ka një mision që synon të mbështesë studentin në rrugën e qytetarisë dhe integritetit të tij social.

Ndihem shumë mirë në rrugën që kam zgjedhur! Të duhet të kryej një kurs trajnimi në fushën time, përveçse zgjedhjes së lirë në ndonjë zyrë ose kompani, kam mundësinë e kryerjes së këtij trajnimi në universitet. Këtu unë mund të gjej pafund rrugë për të ardhmen time!



FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA DHE INDUSTRIVE KREATIVE



ADA OSMANI
Informatikë e Aplikuar
viti II

Zgjedha për të vazhduar studimet e larta në "Universitetin Barlet" si një universitet elitari, i cili nëpërmjet stafit shumë të përgatitur pedagogjik mundëson një rrugëtim eficient drejt suksesit. Gjithashtu "Universiteti Barlet" ofon bursa të shumta për studentët e saj çdo vit për t'i inkurajuar të rinjtë të cilët dëshirojnë të vazhdojnë studimet e larta në "Barlet". Një pikë strategjike e "Universitetit Barlet" janë edhe ekzistenca e klubeve të shumta studentore të cilat janë gjithëpërfshirëse, ku përpos zhvillimit të mendimit kritik, human dhe atij intelektual, mund të shpalosësh kreativitetin, njohuritë dhe aftësitë personale. Nëse dëshironi që e ardhmja juaj të jetë e ndritur dhe e suksesshme ka vetëm një mënyrë për të arritur atje, dhe kjo vetëm me "Universitetin Barlet".



FANILA BELBA
Arkitekturë, viti I

Une jam Fanila! Kam zgjedhur të studioj në "Universitetin Barlet", i cilësuar si universiteti me miqësor për studentët. Në këtë universitet vlerësohet puna dhe investimi i kryer në vite, e pasqyruar në mbështetjen financiare nëpërmjet bursave dhe mundësitë e punësimit. Përdorimi i teknologjisë së fundit në mësimdhënie, stafi i kualifikuar dhe jeta studentore e bëjnë Barletin të jetë shumë konkurrues me universitetet e tjera.



KRENAR PËR BARLETASIT!

JON VRENOZI

Edukim Fizik dhe Sporte,
viti I



Kam filluar sportin e judo's në moshën 4-vjeçare. Jam shpallur 7 herë kampion kombëtar për të rritur dhe 7 herë në kupën e Republikës. Gjithashtu në kampionatin ballkanik kam zënë vendin e parë dhe jam shpallur dy herë nga komiteti olimpik shqiptar si një nga 10 sportistat më të mirë në Shqipëri.

MEDEA AVDULI


Drejtësi, viti I



Duke qene se debati i strukturuar dhe mendimi kritik është një nga ato gjëra që më ka pëlqyer pa masë ta bëj kur isha në shkollën e mesme, zgjedha të isha pjesë e programit "Dimensioni 4" në Rtsh3, një format i cili gjimnazistët debatonin rreth temave sociale, nxirnin në pah mendimin e tyre kritik pa barriera, diskutohesh rreth tema të cilat i prekjin, ata shoqërinë shqiptare dhe jo vetem. Pas një sezoni shumë të mirë si debatuese e këtij programi mu ofrua mundësia që këtë sezon të isha nën moderimin e tij, një nga eksperiencat më të bukura, por dhe një nga përgjegjësitë më të mëdha. Krahas shkollës dhe studimeve për drejtësi, moderimi si pasion i imi tashmë është kthyer në një punë, në pritje të mbylljes së një sezoni të suksesshëm televiziv për promovimin e mendimeve kritike te të rinjtë.

JUEN SHABANAGA

Edukim Fizik dhe Sporte
viti II



Unë jam Jueni dhe kam 15 vite që merrem me fitness. Vitin e fundit kam konkuruar në konkursin e kupës së Shqipërisë për bodybuilding ku jam shpallur kampion në Man's classic bodybuilding. Aktualisht po përgatitem për kampionatin kombëtar ku sigurisht synoj për të fituar dhe për të vazhduar më tej rrugëtimin në fushën e bodybuilding.

MELISA BALLIU

Edukim Fizik dhe Sporte
viti II



Say yes to the impossible! Kështu e nisa rrugëtimin tim. Në moshën 18 vjeçare nisem në një eskperiencë të paharrueshme 2-vjeçare duke lundruar rreth e rrotull brigjeve të Amerikës Latine. Më pas kthehem në vendlindjen time dhe nis studimet në Barlet. Sot jam në vitin e dytë Bachelor "Edukim Fizik dhe Sporte", ndërkohë bashkëpunoj me organizata botërore sportive. Në të ardhmen synoj që nëpërmjet marrëdhënieve ndërkombetare dhe studimeve, të sjell kontributin tim nëpërmjet sportit, zhvillimin e komuniteteve në Shqipëri.

ALBAN BERMETA

Edukim Fizik dhe Sporte", viti III



Unë jam Alban Bermeta i programit të studimit "Edukim Fizik dhe Sporte", viti i 3-të. Arrita të siguroj fitoren e 8-të në boksion profesionist kundër boksierit nga Hungaria duke siguruar kupën Boksieri më i mirë në turneun memorial "Skender Kurti".



QEVERIA STUDENTORE

Qeveria Studentore është organizim i studentëve në Universitetin "Barleti", i përbërë nga përfaqësuesit e studentëve nga të gjitha fakultetet dhe departamentet përbërëse të zgjedhur në mënyrë demokratike. Objektivi themelor i Qeverisë së Studentëve është që të sigurojë zhvillimin akademik të studentëve dhe rritjen e tyre sociale dhe personale. Qeveria e Studentëve zgjidhet çdo vit nga votat e studentëve. e Studentëve promovon, koordinon dhe inkurajon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfaqësimin e ideve e opinioneve të tyre në organet drejtuese të Universitetit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe synon garantimin e shërbimeve si:

- Funksionimin e Klubeve Studentore
- Shërbimeve dhe Aktiviteteve Sociale
- Përmirësimin e jetës në kampus.

NJIHUNI ME SENATORËT E QEVERISË STUDENTORE TË "UNIVERSITETI BARLETI"

Adelajda Daja,
Marketing, Publicitet dhe
Marrëdhënie me Publikun, viti I



Çfarëdo lloj gjëje që mendja e njeriut mund ta konceptojë dhe besojë, ajo mund edhe ta arrijë.

Napoleon Hill

Adrian Gjonaj
Psikologji, viti II



E vetmja mënyrë për të bërë punë të mëdha është që ta doni atë që bëni

Steve Jobs

Ajvi Rrecek
Edukim Fizik dhe Sporte, viti I



Perfeksioni nuk është kurrë masa për të matur suksesin. Por është koha e duhur për tju vënë nga pas zakoneve që formojnë përsosmërinë.

Alondo Xhafa
Edukim Fizik dhe Sporte, viti II



Përpiquni jo që të jeni një sukses, por që të jeni një vlerë.

Albert Einstein

Arishela Abdi
Drejtësi, viti 2



Sekreti i krijimtarisë është të dini se si të fshehni burimin tuaj!

Albert Ainshtain

Dajana Ponari
Shkenca Politike, viti I



Unë vetëm nuk mund ta ndryshoj botën, por unë mund të hedh një gur në ujë, për të krijuar shumë valë.

Nënë Tereza

Daniel Kacabani
Edukim Fizik dhe Sporte, viti II



Ndrysho mendimet e tua dhe do të ndryshosh botën tënde

Dorian Tepelena
Edukim Fizik dhe Sporte, viti II



Ajo që ne arrijmë së brendshmi, do të ndryshojë realitetin e jashtëm.

Plutarku

Elfaneada Dake
Marketing, Publicitet dhe
Marrëdhënie me Publikun, viti III



Hakmarrja më e mirë është sukcesi i madh

Frank Sinatra

Endri Pire
Edukim Fizik dhe Sporte, viti II



Mënyra se si të fillosh është që të lësh llafet dhe t'ia nisësh punës.

Walt Disney

Enerida Metani
Arkitekturë, viti II



Kam mësuar se njerëzit do të harrojnë atë që u thoni, njerëzit do të harrojnë atë që u keni bërë, por njerëzit nuk do të harrojnë kurrë se si i keni bërë të ndjehen.

Moya Angelou



Era Arapi
Edukim Fizik dhe Sporte, viti II



Një person që nuk ka gabuar asnjëherë, nuk ka provuar asnjëherë një gjë të re.

Albert Einstein

Erika Balla
Financë, bankë, sigurime
dhe pasuri të paluajtshme, viti I



Ne nuk mund të ndihmojmë të gjithë, por të gjithë mund të ndihmojmë dike.

Ronald Reagan

Erizarta Zero
Financë Kontabilitet, viti I



Unë nuk mund të ndryshoj drejtimin e erës, por mund të rregulloj velat e anijes time, për të arritur gjithmonë në destinacionin tim.

Jimmy Dean

Esmë Rrokja
Edukim Fizik dhe Sporte, viti III



Gjëja më e vështirë është vendimi për të vepruar, pjesa tjetër është thjesht këmbëngulje.

Amelia Earhart

Eva Mihana
Financë Kontabilitet, viti III



Investimi në dije paguan interesin më të mirë.

Benjamin Franklin

Fabio Arapi
Informatikë, viti I



Beso që mund t'ia dalësh dhe ke arritur në gjysmën e rrugës.

Theodore Roosevelt

Lorada Jemini
Arkitekturë, viti I



"Mos harroni se dështimi është një ngjarje, dhe jo një person".

Zig Ziglar

Melisa Mulaj
MSH. E drejte penale dhe
Kriminologji, viti I



Suksesi është me ata që përpiqen.

Dr. Erion Kristo

Hervis Arapi
Edukim Fizik dhe Sporte, viti II



Ose ti e komandon ditën tënde, ose dita jote të komandon ty.

Jim Rohn

Ina Brahja
Edukim Fizik dhe Sporte, viti II



Arsimi është arma më e fuqishme që mund ta përdorni për të ndryshuar botën.

Nelson Mandela

Jurgen Spaho
Informatikë, viti II



Ne nuk mund të ndihmojmë të gjithë, por të gjithë mund të ndihmojmë dikë.

Ronald Reagan

Koi Barbullushi
Informatikë viti III



Ju nuk mund të bëni asgjë, nëse ju mungon entuziazmi.

Henri Ford

Fabjona Hasani
Edukim Fizik dhe Sporte, viti III



Mos harroni se mos arritja e asaj që dëshironi, ndonjëherë është një goditje e mrekullueshme e fatit

Dalai Lama

Hajdi Estrefi
Menaxhim Biznesi, viti I



Personi i vetëm që jeni të destinuar të bëheni, është personi që ju vetë vendosni të bëheni.


Ralph Waldo Emerson

Klea Tomçini
Menaxhim Biznesi, viti III



Suksesi është të shkosh nga dështimi në dështim, pa e humbur entuziazmin.

Uinston Churchill



Leonard Uldeadaj

Menaxhim Biznesi, viti III

"Shkoni sa më larg që mund të shihni; kur të mbërrini atje, do jeni në gjendje të shihni më larg".

XH.P Morgan



Marsjola Selmani

Msh Arkitekturë

"Është më se e vërtetë që ju mund të keni suksesin më të mirë dhe të shpejtë, duke ndihmuar të tjerët të kenë sukses".

Napoleon Hill



Medea Avduli

Drejtësi, viti I

"Vetëm ata që guxojnë të dështojnë në masë të madhe, mund të arrijnë suksese të mëdha".

Robert F. Kenedi



Nikola Trebicka

Edukim Fizik dhe Sporte, viti III

"Bëni punën tuaj me gjithë zemër, dhe do të keni sukses – ka qaq pak konkurrencë".

Elbert Habard



Red Balla

Edukim Fizik dhe Sporte, viti I

"Dështimet janë gjurmët e gishtërinye në rrugën drejt arritjes së qëllimeve".

K.S Ljuis



Sara Bekteshi

Punë Sociale, viti II

"Njeriu që ka arritje në jetën e tij bën shumë gabime, por ai nuk bën kurrë gabimin më të madh nga të gjithë – të mos bërit asgjë".

Benxhamin Frenklin



Sonja Bajramaj

Edukim Fizik dhe Sporte, viti I

Kush e dëshiron suksesin aq fort sa dëshiron të marrë frymë, atëherë do të jesh vertet i suksesshëm.

Samuela Lile

Financë, bankë, sigurime dhe pasuri të paluajtshme

"Nëse mendoni se jeni shumë i vogël për të pasur ndonjë lloj ndikimi, provoni të flini në shtrat me një mushkonjë".

Anita Rodik



Megi Hazizi

Marketing, Publicitet dhe Marrëdhënie me Publikun, viti II

"Suksesi pengohet nga dështimi në dështim, por pa asnjë humbje të entuziazmit".

Uinston Çerçill



Sindi Fuga

Psikologji, viti I

Unë nuk mbërrita këtu, duke e uruar apo shpresuar, por duke punuar për të.

Esti Lauder



Valmir Cani

Edukim Fizik dhe Sporte, viti II

Suksesi duket të jetë i lidhur me veprimin. Njerëzit e suksesshëm janë në lëvizje. Ata bëjnë gabime, por nuk ndalen kurrë".

Xhon Uilard Merrot



Vilson Gjeshaj

Punë Sociale, viti III

"Sekreti i ekzistencës njerëzore nuk qëndron vetëm në të jetuarit, por edhe në të kuptuarit se për çfarë po jeton."

Fyodor Dostoevsky



Klea Shqypi


Drejtësi, viti I

"E vetmja gjë që ju pengon nga arritja e asaj që doni, është historia që vazhdoni t'i tregoni vetes".

Toni Robins

STUDENT'S TALK

ÇFARË DUHET BËRË QË TË RINJTË TË JENË ENTUZIASTË PËR TË ARDHMEN E TYRE NË VENDIN E TYRE?



Sindi Fuga

Psikologji, viti I

Rinia e sotme ka për tendencë që të iki nga vendlindja e tyre, pasi nuk gjejnë përkrahje, një treg pune të denjë, një të ardhme të sigurt, një karrierë të ndritur dhe nuk mendojnë se mund të krijojnë diçka stabel për të ardhmen e tyre. Ky fenomen sa vjen e shtohet dita ditës, të rinjtë mundohen të largohen sa vjen e më shumë dhe të krijojnë një jetë të re larg familjes së tyre.

Rinia duhet të ngrejë zërin për të drejtat e tyre, për padrejtësitë që u bëhen çdo ditë, për pa-sigurinë që ndjejnë në vendin e tyre dhe shumë gjëra të tjera për të mirën e tyre. Të rinjtë duhet të jenë sa më entuziastë për të ardhmen e tyre dhe për të arritur këtë gjë ata duhet të kenë më shumë siguri në shoqërinë e tyre, duhet të jenë më të lirë në zgjedhjet e tyre, duhet të mësojnë për të vazhduar përpara dhe për të bërë ndryshimin në fillim tek vetja e tyre e më pas në komunitet. Të rinjtë kanë si dëshirë që të argëtohen dhe të shijojnë moshën e tyre, por njëkohësisht ata duhet të studiojnë që të arrijnë rezultate të larta për të pasur një të ardhme sa më të bukur dhe frytdhënëse.

Për të arritur të gjitha dëshirat dhe detyrimet e tyre rinia duhet të ketë të ardhura të mira me anë të të cilave arrijnë të realizojnë çdo gjë që duan. Që rinia të jetë sa më entuziaste për të ardhmen e tyre në vendin e tyre ata duhet fillimisht të jenë të lumtur në vendin e tyre dhe të bëjnë maksimumin për të ardhmen e tyre. Vendi jonë do të ishte një vend më i bukur nëse do të kishte siguri dhe drejtësi për të gjithë ne.

Ndryshimi duhet të fillojë nga ne, më pas nga shoqëria jonë!



Artemisa Bajrami

Informatikë, viti II

Që të rinjtë të jenë entuziastë për të ardhmen e tyre në vendin tonë duhet orientim dhe këshillim mbi karrierën dhe mundësitë që iu ofrohen. Duhet modele suksesi, edukim, emancipim, integrim dhe zhvillim, qendra kulturore ku të kultivohet arti dhe patriotizmi. Angazhimi në turizëm në vendin tonë, i cili sjell të mira

ekonomike, shkëmbim kulturor i cili orienton drejt objektivit kryesor. Punësimi për të rinjtë, por edhe familjarëve të tyre pasi ekonomia është faktori kryesor i largimit të të rinjve.



Anteo Sokoli

Informatikë, viti I

Refreni i të rinjve është:

"Do iki nga ky vend, këtu nuk jetohej. Ky vend nuk bëhet etj"

Sa e dhimbshme!

Që të largohet ky pesimizëm dhe të rinjtë të jenë entuziastë për jetën dhe vendin e tyre ku të rikthejnë shpresën duhet të permirësohet arsimiti në çdo hallkë duke ndryshuar sistemin në tërësi dhe politikën arsimore, të sigurohet permirësimi i të rinjve sipas meritës duke rritur pagat, rritja e nivelit ekonomik në familjet shqiptare (ulet emigracioni, të rinjtë punojnë në vendin e tyre dhe janë më të sigurt për të ardhmen). Gjithashtu mendoj se duhen permirësuar politikën sociale, të hapen sa më shumë degë profesionale në shkolla dhe të kenë më shumë mundësi argëtimi (shfaqje, koncerte, kënde sportive..etj)



Fabio Arapi

Informatikë, viti I

Në vendin tonë përse i përket vitit 2022 ka një sërë problemesh të lidhura drejtpërdrejt me një numër faktoresh të cilët ndikojnë dhe ndodhin, e një ndër fenomenet më problematike për shoqërinë shqiptare është edhe largimi i të rinjve në vende të ndryshme nëpër botë. Çdo vit edhe më shumë dëgjojmë sesi një numër madhor i të rinjve shqiptar, vendosin të largohen nga vendi ynë në kërkim të një jete më të mirë për ta gjithashtu edhe për familjet e tyre. Por pyetja që duhet të shtrojmë është "Pse ndodh pikërisht ky fenomen?"

Arsyet mund të jenë të shumta, por ajo që duhet të përmendim është se këtij vendi i mungon një frymë, një vizion për të ardhmen, gjë e cila i bën të rinjtë të mendojnë se nuk ekziston një e ardhme që ata e kanë



ëndërruar dhe kanë punuar fort, prandaj e kërkojnë atë të ardhme diku tjetër. Në këtë mënyrë tek ndryshimet që duhen bërë menjëherë në vendin tonë mund të përmendim: Investimin masiv në sistemin arsimor, ku çdo student mund të ketë mundësi të studiojë dhe të aftësohet për profesionin e tij sipas standardeve europiane. Një faktor tjetër që mund të përmendim është përfshirja e studenteve në forma të ndryshme nëpër institucione shtetërore apo dhe ato private të cilat i përshtaten profesionit të tyre, ku në këtë mënyrë ata mund të oftohen gjithashtu dhe të kuptojnë drejtimin e tyre për të ardhmen në këtë vend. Faktori i fundit që do doja të përmendja në nxitjen e entuziasmit të studentëve për të ardhmen e tyre në këtë vend do të ishte implementimi i këtyre studenteve menjëherë pas mbarimit të studimeve në ambiente ku ata mund të ushtrojnë profesionin e tyre, pasi në këtë mënyrë ata e kuptojnë se nuk është e nevojshme një pritje e gjatë kohore në mënyrë që ata të fillojnë rrugëtimin e tyre të jetës.



Megiana Doda
Punë-Sociale, viti I

Rinia simbolizon agimin e Diellit, që çdo mëngjes ngjall shpresat e nxit buzëqeshjet për një ditë më të mirë se ajo e djeshmja. Kështu, nga çdo gjeneratë e re lind një shpresë e re për ndryshim.

“Ambicia është hapi i parë i suksesit, hapi i dytë është veprimi”

Fati i popullit tim, është fati im”, thoshte Pjetër Bogdani, që duhet të shërbejë si mësim për këdo, e sidomos për ne të rinjtë.

Mungesa e standardeve të larta në arsim, mundësitë e pakta për punësim, pagat e ulëta, mungesa e profesionalizmit, etj, të gjitha këto bëjnë që entuziazmi që ishte po shuhet ngadalë brenda secilit prej nesh.

Nuk mjafton vetëm diploma, por edhe cilësia e mësimdhënies, materialet cilësore studimore, praktika dhe eksperiencat profesionale, për të mos folur pastaj për ambientin e shëndetshëm studentor, lehtësinë e marrëdhënieve me autoritete universitare, perspektivën për punësim në degën e zgjedhur, larminë e madhe të vendeve të punës, nivelin e kënaqshëm të pagave dhe ambientin e shëndetshëm profesional.

Nëse këto plotësohen në vendin ku çdo njeri jeton, secili do ndjehet i dobishëm në vendin e tyre.



Fiorela Kofsha
Operator dhe këshillues në
përkujdesje shëndetsore, viti 2

E ardhmja e të rinjve, varet nga ata. “Që njeriu të ketë një të ardhme, duhet të luftojë që ta fitojë të ardhmen”

Por si?

E vërteta është që njeriu përballet me shumë vështirësi në jetë, por asnjëherë nuk duhet të dorëzohet nëse dëshiron ta fitojë një të ardhme.

Me pak mundim dhe përpjekje, njeriu e arrin të ardhmen, sigurisht të ardhmen që do. Gjithmonë, njeriu duhet të jetë optimist dhe entuziast kur bëhet fjalë për të siguruar një të ardhme. Nuk është e thënë që njerëzit të largohen nga vendi i tyre, sepse vetëm kështu mund ta sigurojnë një të ardhme.

Edhe pse ekonomia e vendit të tyre mund të jetë e ulët dhe kjo gjë i bën të mendojnë që nuk sigurojnë të ardhme, nëse punojnë fort, mund t’ia dalin.

“Të sigurosh një të ardhme është e vështirë, kurse ta humbasësh të ardhmen që ke siguruar është shumë e lehtë”

“Nëse sigurojmë një të ardhme dhe e humbasim atë, është shumë vështirë ta sigurojmë sërish”, ndaj duhet të bëjmë kujdes.

Çfarë duhet të bëjnë të rinjtë që të sigurojnë një të ardhme në vendin e tyre?

Përveç se duhet të punojnë fort dhe duhet të kursejnë, në mënyrë që të kenë një të ardhme të ndritur.



KLUBET STUDENTORE

KLUBI I LIBRIT

Bota u përket atyre që lexojnë!

R. Holland

Shumë njerëz duan të lexojnë, por mund të jetë e vështirë të gjejnë dikë për të folur rreth librit, apo të gjejnë dikë që t’i orientojë drejt një libri që të përmbushë dëshirën dhe fantazinë e tyre. Për të apasionuarit e librit, ky është klubi i duhur.

Gjatë këtij viti akademik studentët e Klubit Books &Tech me datë 04.02.2022 kanë organizuar takim me gazetaren e kulturës Luella Myftari, me të cilën shkëmbyen përvojën e saj mediatike, pasionin për letërsinë dhe shkrimet në fushën e kritikës letrare.

Po ashtu, kurioziteti i studentëve ishte për të kuptuar procesin e botimit të një libri, marrjen e të drejtës së autorësisë, përkthimet dhe mënyrën e funksionimit të tregut në vendin tonë. Për të gjitha këto me datë 31.03.2022 kishin të ftuar drejtuesen e shtëpisë botuese “Dudaj”, Arlinda Dudaj për të ndarë punën dhe eksperiencën e saj me studentët.

Nisma “Dhurimi i librit pasuron” ishte në fokusin e klubit gjatë muajit prill, muaj i shpallur si “muaji i librit” ndërkombëtarisht, ku me datë 22.04.2022 Biblioteka e Universitetit në bashkëpunim me profesor Erion Kristo dhuruan tituj të ndryshëm me libra për studentët.



Në të njejtin muaj me datë 27.04.2022 u organizua një vizitë në shtëpinë muze të shkrimtarit I. Kadare ku studentët përjetuan një eksperiencë krejtësisht ndryshe. Të parit nga afër një nga ambjete ku shkrimtari ka kaluar një pjesë të jetës së tij dhe ka shkruar shumë libra të krijimtarisë së tij, na e mundëson të ngjallim në imagjinatë një copëz të jetesës së tij private.

Në vijimësinë e takimeve “Tako Shkrimtarin”, me datë 19.05.2022 klubi ftoi shkrimtarin Viktor Canosinaj. Një brez që është rritur me letërsinë për adoleshentë që ky shkrimtar shkruan do të ishte krejtësisht e pashmangshme të mos e kërkonin dhe dëshironin një takim me shkrimtarin që i ka bërë të ëndërrojnë. Shkrimtari që i ka magjepsur me librat e tij në moshën e fëmijërisë dhe adoleshencës, tanimë, do vazhdojë të mbushi botën e tyre me fantazi me letërsinë për të rritur që ai shkruan.

Klubi Books &Tech do të vijojë me aktivitete, lexime, dhe takime me shkrimtarë të tjerë në vazhdimësi.




KLUBI I ARKITEKTIT BARLETAS

Klubi i Arkitektit Barletas në UniBa, është një organizatë vullnetare e drejtuar nga vetë studentët e Arkitekturës e cila gjatë gjithë vitit akademik organizon aktivitete akademike dhe sociale dhe ofron shërbime mbështetëse që përbushin nevojat unike të studentëve tanë të arkitekturës.

Grupi mbledhet minimalisht një herë në muaj, por në disa periudha edhe më shpesh, për të dëgjuar leksione të hapura nga arkitektë të njohur vendas ose të huaj, për të ofruar grupe paneli ose diskutimi mbi një libër apo mbi një temë të caktuar ose për të kryer aktivitete studimore dhe argetimi në zona me rëndësi historike dhe arkitektonike. Temat që trajtohen zakonisht në diskutimet në grup sillen rreth librave të arkitekturës ose filmave të shkurtër të animuar.

Ky klub është një organizatë e angazhuar për të ndihmuar njëri-tjetrin. Ofron një ndjenjë komuniteti dhe një forum për të ndarë pikëpamje të ndryshme. Disa nga aktivitetet e organizuara kete vit akademik 2021-2022, janë:

- Leksioni i hapur dhe workshop i arkitektit dhe sipërmarrësit brazilian Marcio_Sequiera i cili ka shpikur metodologjinë inovative në edukim dhe projektim të strukturave në arkitekturë dhe inxhinieri. Datat 04 - 05.11.2021.
- Studentët e Arkitektures të shoqëruar nga lektorët realizuan një vizitë në kantierin e ndërtimit të godinës polifunksionale "Eyes of Tirana" 20.12.2021
- Një film i animuar që tregon jetën e trazuar të Vinsent Van Gog, për të dorëzuar letrën e tij të fundit të vëllait _ 01.04.2022
- Vizitë studimore në Parkun Arkeologjik të Apolonisë në Fier, 10.05.2022
- Leksione të hapura me arkitektë të ftuar dhe debate me studentët nga arkitektë vendas dhe të huaj: si Pirro Vaso (13.01.2022), Enrico Porfio (02.12.2021), Harabel Studio (18.03.2022), Klodiana Emiri, Ervin Taçi, Frida Pashako (07.04.2022), Matali Crasset (28-29.04.2022)
- Takim me Alumnajt dhe bisedime mbi eksperiencat dhe rrugëtimin e tyre: Fjordi Rroshi (21.10.2021)



KLUBI I ARTIT DHE KULTURËS

Pranverë në UniBa

Me rastin e Ditës së Verës, me 15.03.2022 Qeveria Studentore UniBa në bashkëpunim me Klubin e Artit dhe Kulturës organizon aktivitet argëtues me studentët nga të gjitha programet e studimit, duke vazhduar traditën e bukur të ditës së verës në UniBa.

Në këtë takim, përveçse u shijuan ëmbëlsirat tradicionale dhe u dhuruan verore sipas traditës së kësaj feste, nuk munguan kërcimet dhe lojrat argëtuese.

E ku ka më bukur se të ndërthuret jeta akademike e studentëve në UniBa nëpërmjet traditës, kulturës dhe dashamirësisë.



Seriali "Katrori i Pushtetit" në Barlet

Në 8.02.2022 Klubi i Artit dhe Kulturës & Klubi i Medias në bashkëpunim me Rrjeti "Barazi në Vendimmarrje" dhe Era Film Production realizuan ëorkshop-in në kuadër të nismës "Make it Visible" mbi "Lirinë e Medias".

Studentët u njohën me serinë e parë të serialit "Katrori i Pushtetit" i cili nxiti shumë diskutime për mënyrën e realizimit, shfaqjes së problematikave dhe historisë së treguar në këtë serial.

Gjatë këtij workshop-i mori pjesë Edlira Çepani, koordinatore kombëtare e Rrjetit "Barazi në Vendimmarrje" dhe ishin të ftuar regjizori Robert Budina, gazetarët Fatjona Medini dhe Xhoi Malësia të cilët ndanë me studentët sfidat e rrugëtimin në realizimin e serialit.

"Katrori i pushtetit" është seriali më i ri që ka nisur në kinematë e kryeqytetit. Me regji të Robert Budinës një projekt i mbështetur nga Bashkimi Europian, trajton shoqërinë e cila ndodhet pikërisht në një katror pushtetesh ku përfshihet politika, bota e krimit dhe media.



Klubi i Artit dhe Kulturës

Hapen audicionet për artistët e rinj në aktrim dhe muzikë
Audicionet do gjykoen nga profesionistë të fushës

KLUBI I KARRIERËS

Çfarë është e rëndësishme për mua
26.01.2022

Klubi i Karrierës, organizoi trajnimin me temë: "Çfarë është e rëndësishme për mua" nga Msc. Grejsa Dushku dhe Msc. Diantina Zuna.

Trajnimi u zhvillua më datë 26.01.2022, klasa 021 gjatë orarit 11.15 – 13.15.

Qëllimi i trajnimit ishte orientimi në karrierë për të rinjtë që të marrin vendime realiste dhe të mirë informohen për karrierën e tyre duke njohur së pari vetveten.

Trajnimi u bazua tek testet e ndryshme për të vlerësuar më mirë aftësitë personale të secilit dhe për të kuptuar veprimet e tyre në të shkuarën, për të bërë zgjedhje të duhura në të tashmën.

Ky takim ishte i pari i këtij lloji, për t'u pasuar me trajnime të tjera nga ekspertë karriere lidhur me tregun e punës, menaxhimin e emocioneve në një intervistë pune etj.

Në fund të trajnimit, studentët e pranishëm parashtruan të gjitha pritshmëritë, propozimet dhe kërkesat e tyre lidhur me zyrën e Karrierës dhe të ardhmen e tyre profesionale, të cilat Universiteti Barleti i ndjek me prioritet.

Orientim dhe këshillim për tregun e punës nga ekspertë karriere 03.02.2022

Klubi studentor i karrierës në bashkëpunim me ekspertë karriere të kompanisë "Blue Filters", organizuan më datë 03.02.2022, ora 11.00, një trajnim mbi tregun e punës në Shqipëri dhe orientimin e të qenit i suksesshëm në të dhe ofruan mundësi punësimi kryesisht për studentët e programeve "Menaxhim Binzesi", "Marketing, Publicitet dhe Marrëdhënie me Publikun", "Informatikë e Aplikuar", etj.

Eventi u moderua nga Msc. Grejsa Dushku dhe Msc. Diantina Zuna.



Përgatitje cv dhe letër motivimi

Zyra e Karrierës & Klubi i Karrierës me Msc. Grejsa Dushku dhe Msc. Diantina Zuna, pozicionuar në Holl, Kati 0, ofrojnë trajnime për përgatitje CV, letër motivimi dhe parapërgatitje për intervistë pune, cdo të martë dhe të premte ora 12.30 e në vijim.

Çdo i interesuar mund të kontaktojë për të lënë takim tek:

career-alumni@umb.edu.al ose
admissions.co@umb.edu.al



KLUBI I MEDIAS

Klubi i Medias nis punën me numrin e ardhshëm të revistës studentore "UniBa Magazine"

Me datë 12.01.2022 studentët e Klubit të Medias u mbledhën për të përfunduar të gjitha detajet e rubrikave të numrit të parë të revistës studentore "UniBa Magazine". Pas shumë muajsh punë e palodhur nga anëtarët e klubit, finalizuan me sukses punën e tyre dhe rinisën menjëherë punën për ndarjen e rubrikave për numrin e dytë të revistës.

Klubi i Medias në Radio Tirana

Studentët e Klubit të Medias vazhdonë traditën e pjesëmarrjes në emisionet e organizuar nga Radio Tirana. Temat e diskutimit ishin: "17 maj, Java e Shoqërisë Civile në Shqipëri me një numër të aktiviteteve që janë në qendër të rinjtë", "Të rinjtë në veprim" - Pjesëmarrja në ekonominë politike, fuqizimi dhe integrimi social".



Klubi i Medias "Digital Marketing"

Me datë 25.03.2022 Anaid Kaloti ishte i ftuari i studentëve – Organizuar nga Qeveria Studentore dhe Klubi i Medias për studentët e programeve të ndryshme, me qëllimin e vetëm "Rritja e njohurive në marketingun dixhital".

Cilat janë të rejtat e fundit në marketingun dixhital, si të postojmë, kur, pse dhe për kë duhet të postojmë në rrjete sociale dhe jo vetëm, këto ishin disa nga temat që Anaidi shpjegoi me shumë pasion.

Ai solli shpirtin e kërkimit të dijes në çdo moment tek të rinjtë pjesëmarrës, duke motivuar të studiojnë më shumë rreth kësaj industrie gjithmonë në rritje.



KUPA E VENDIT TË PARË RRËMBEHET NGA MERITAT E FUTBOLLISTËVE BARLETAS

Nga data 2 deri 5 Qershor në ambjentet e Akademisë Football Republic u zhvillua Kampionati Kombëtar Universitar I Futbollit për Meshkuj dhe Femra organizuar nga Federata Shqiptare e Sportit Universitar.

Ekipi ynë i meshkujve i Universiteti Barleti morri kupën e vendit të parë në këtë kampionat kurse ekipi i vajzave vendin e tretë.

Vitin tjetër në finalen e Kampionatit Europian për Futbollin që do të zhvillohet në Tiranë, Shqipëria do të përfaqësohet me ekipin e futbollit të Universitetit Barleti.

Urime dhe suksese të mëtejshme kampionëve drejtuar me profesionalizëm nga pedagogu Agim Bedini!



KLUBI I PSIKOLOGJISË

Në kuadër të Ditës Botërore të Ndërgjegjësimit për Autizmin, Klubi i Psikologjisë organizoi një takim për të ndarë dhe diskutuar informacionet e studimeve të fundit në lidhje me incidencën dhe shkaqet e autizmit.

Gjithashtu pjesë e rëndësishme e takimit ishte ndarja e përvojës së punës bazuar tek terapia ABA (Analiza e Aplikuar e Sjelljes), në mënyrë që studentët të njohin në detaje teknikat që përdoren gjatë terapisë.

Diten e enjte, date 05.05.2022 Klubi i Psikologjisë organizoi një takim me qëllim organizimin e punës për realizimin e një studimi për të matur shkollën e varësisë që kanë studentët në përdorimin e rrjeteve sociale dhe ndikimi i saj në nivelin e lumturisë, nivelin e perceptuar të stresit dhe ankthit.



KLUBI I SIPËRMARRËSIT BARLETAS

Talking session | Ermal Mamaqi

Triple city më datë 30 mars 2022 së bashku me klubin e Sipërmarrësit në Universitetin Barleti kishin të ftuar Ermal Mamaqi për të ndarë me studentët rrugëtimin e tij në media, sipërmarrje dhe trajnimet "life long learning".

Ermali ndau me studentët një pjesë nga trajnimi i tij "Mendo. Ndrysho. Fito"

Në aktivitetet morën pjesë më shumë sesa 150 studentë të cilët patën mundësinë të drejtonin pyetje mbi sipërmarrjen dhe trajnimet


Pitching like a pro

Triple City, më datë 2 shkurt 2022, në bashkëpunim me Klubin e Sipërmarrësit Barletas organizuan trajnimin "Pitching like a Pro".

Ky trajnim u mbajt nga Amir Esmailakhtar i cili është profesor në Universitetin Barleti si dhe trajnues dhe mentor i njohur në ekosistemin e startup-eve.

Në trajnim u ndanë pikat kryesore që startup-et duhet të dinë për të mbajtur një prezantim përpara jurisë, sipërmarrësve, etj.

Gjatë aktivitetit, studentët patën mundësi të diskutonin edhe strategjitë e futjes në treg të disa prej bizneseve ndërkombëtare. Në fund të aktivitetit studentët u pajisën me certifikatë pjesëmarrje.



KLUBI I SPORTIT

HIKING NE MALIN E DAJTIT



KAMPIONATI I QITJES



KAMPIONATI I VOLEJBOLLIT MIDIS FAKULTETEVE



PADEL ITALIA



KLUBI I VULLNETARËVE

Klubi i vullnetarëve ka në fokus ndërtimin e një skuadre vullnetarësh me studentë Barletas, me qëllim sensibilizimin dhe përfshirjen e tyre në fushata humanitare për çdo muaj.

Klubi synon kultivimin, zgjerimin dhe mësimin e ndjenjave njerëzore, nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete dhe organizime të ndryshme vullnetare.

Për t'iu ardhur sadopak në ndihmë familjeve në nevojë, studentët kanë ndërmarrë dhe janë organizuar duke kontribuar me paketa të ndryshme ndihme.

Barletasit iu kanë ardhur në ndihmë shumë familjeve në prag të festave të fundvitit dhe më tej. Me kontributin dhe iniciativën e studentit Alban Bërmeta në prag të festave të fundvitit u ndihmuan 15 familje në nevojë me ushqime.

Plotësimi i dëshirës së Albertos nga Lushnja për të pasur një karrige për të lëvizur për shkak se nuk mund të lëvizte dot, u plotësua falë kontributit të Barletasve. Gjithashtu ndihma e familjeve të tjera në nevojë, të identifikuar nga vetë studentët e klubit.

Iniciativat vullnetare kanë si synim ndërgjegjësimin e të gjithë studentëve se; "Të ndihmosh dhe të sjellësh sadopak ndryshim në jetën e dikujt, fal lumturi e shpresë. Të dhurosh, të jep më shumë kënaqësi se të marrësh!"

"Ne s'mund të bëjmë dot gjëra të mëdha, vetëm gjëra të vogla me dashuri të madhe.
-N.Tereza-"

E kthyer tashmë në një traditë misioni i Klubit të Vullnetarëve vazhdon.....



DHURIMI KARROCËS



Klubi i Vullnetareve 5 dhjetori



Klubi i vullnetareve muaji prill



Ndihme 15 familjeve ne nevoje



KLUBI LIGJ DHE QEVERISJE

Me 9.03.2022 Klubi Ligj dhe Qeverisje në bashkëpunim me Junior Achievement of Albania në kuadër të programit "Debating Economics" zhvilluan trajnimin e radhës me studentët e klubit, kryesisht ata që kanë dëshirë debatin konstruktiv.

Ky bllok trajnimi ka si fokus fushën e "Kërkimit shkencor dhe shkrimit akademik" parë në aspektin e përgjithshëm dhe më specifikisht si një nga mjetet më të forta për të qenë një debatus i sukseshëm.

Klubi i Debatit do përfaqësojë Universitetin Barleti në konkurset rajonale dhe kombëtare të debatit.

Me 6.05.2022 Klubi "Ligj dhe Qeverisje" në bashkëpunim me Junior Achievement of Albania organizuan trajnimin: "Komunikimi dhe Prezantimi në Publik"

Trajnimi i tretë nga Junior Achievement of Albania, u fokusua tek Komunikimi dhe Prezantimi në Publik. Edhe ky trajnim synon tu japë njohuri që ata do t'i praktikojnë në vijim gjatë angazhimit të tyre në debatet rajonale e kombëtare që do të zhvillohen në vijim.

Ky ishte trajnimi i fundit për këtë Klub dhe më pas do të kalojmë në fazën e debateve rajonale.



AKTIVITETE NË BARLET

EKSKURSION NË SARANDË

Studentët nga programet e ndryshme të studimit nën shoqërimin e Dekanes së Studentëve Dr. Elda Mamoçi, udhëtuan drejt Sarandës, një eskursion i organizuar nga Qeveria Studentore.

Prej dy ditësh në datat 4 dhe 5 qershor, studentët vizituan Ujin e Ftohtë të Tepelenës, Syrin e Kaltër, Sarandën e Himarën, Parkun Kombëtar të Llogarasë dhe gjithë rivierën shqiptare.

Studentët u ndalën në destinacione të rëndësishme të ekoturizmit dhe turizmit elitare ku peisazhi alternohet nga qafat malore, plazhet e mrekullueshëm, fauna nënujore, shpellat dhe deri tek plantacionet me portokaj dhe limona.



BARLETASIT UDHËTOJNË NË MALIN E ZI

Në 25.03.2022 Qeveria Studentore në bashkëpunim me studentët e Universitetit "Barleti" nën shoqërimin e Dekanes së Studentëve, udhëtuan për dy ditë në Malin e Zi.

Ndajesa e parë ishte në qytetin e Ulqinit ku u njohën me atraksione natyrore dhe kulturore si Qyteti i Vjetër i Ulqinit, Ada Bojana dhe Lumi Bojana, Gjiri i Valdanos, Ulqini i Vjetër dhe qyteti i vdekur i Sas.

Ndajesa e radhës ishte në Kotor dhe Budva ku vizituan qytetin e vjetër të Kotorit dhe Budvës, portin e Jahteve, Gjirin e Kotorit (shëtitje me skaf), kërcimtaren e Budvës etj.



VIZITË STUDIMORE NË PARKUN ARKEOLOGJIK TË APOLLONISË ME STUDENTËT E ARKITEKTURËS DHE TURIZMIT

Me 10.05.2022 Departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit në bashkëpunim me Departamentin e Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit organizuan një vizitë studimore në Parkun Arkeologjik të Apollonisë.

Studentët e Arkitekturës dhe Turizmit u njohën me vlerat e arkeologjike, arkitekto-re, kulturore dhe turistike të zonës duke shpalosur njohuritë teorike të marra në auditor.

Vizituan muzeun e Apollonisë, monumentin e Agonoteteve, banesën tipike, stoane dhe shumë objekte të tjera me vlera të larta arkitektonike dhe turistike.

Nën udhëheqjen e Dr. Vera Bushati, Dr. Florina Pazari, Phd. Etleva Dobjani, Dr. Elda Mamoçi dhe MSc.ark.Klea Biçiku, studentet realizuan një tur mbresëlënës në një nga perlat e trashëgimisë kulturore të vendit tonë.



EKO TURIZËM ME ZIPLINE ALBANIA DHE AKTIVITET NË NATYRËN E PETRELËS

Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit, Klubi i Sportit dhe Rekreacionit në bashkëpunim me Drejtorinë e Promovimit dhe Zhvillimit të Industrisë së Turizmit dhe Zipline Albania zhvilluan aktivitetin:

“Eko Turizëm me Zipline Albania dhe aktivitet në natyrën e Petrelës”

Qëllimi i aktivitetit ishte promovimi i Eko Turizmit në rrethinat e Tiranës, shfrytëzimi i burimeve natyrore si dhe pastrimi i zonës duke synuar ndërgjegjësimin për një turizëm në mjedis të pastër.

Aktiviteti filloi me aksionin e pastrimit të territorit pranë një zone në natyrë te lumit Erzen, më pas eksperiencia e Zipline Albania, si atraksioni me i ri në Eko Turizëm.

Në fund u shpërndanë çertifikata për pjesëmarrësit në fluturimin me Zipline.

Studentët shijuan xhiro me varkë kajak në lumin Erzen. Për të apasionuarit u organizuan udhëtime në zonën përreth me mountain bike.



4 SHKURT- DITA BOTËRORE E LUFTËS KUNDËR KANCERIT

Qeveria Studentore organizoi aktivitete në kuadër të 4 shkurtit- Dita Botërore e Luftës Kundër Kancerit.

Një ditë e shoqëruar me mesazhe sensibilizuese, prezantime, video me iniciativën dhe organizim nga studentët e Universitetit Barleti.

I gjithë stafi akademik dhe administrative u solidarizuan me iniciativën e studentëve.

Të pranishëm në aktivitetin përmblylës ishin stafi akademik i UniBa, antarë të Senatit Akademik e Këshillave Studentor të Universitetit të Tiranës dhe gjimnazistë nga shkollat e mesme të Tiranës.



DITA E EVROPËS

Qeveria Studentore organizoi aktivitete në 9 Maj në kuadër të ditës së Evropës. E ftuara speciale Drejtoresha e Integritimit Znj. Admira Jorgji, e cila së bashku me senatorët diskutuan rreth kriterëve që Komisioni për Zgjerimin e Bashkimit Evropian kanë vendosur për integrimin e Shqipërisë dhe si munden të rinjtë të punojnë dhe zhvillojnë vendin për të përshpejtuar procedurat e integritimit.



PLATFORMA ARIO

Të nderuar lexues,

Qeveria Studentore e Universitetit Barleti (UniBa) në bashkëpunim me Institutin Shqiptar për Çështjet Publike (Institutin AIPA) kanë zhvilluar një aktivitet të dendur dhe cilësor edukativo-informues, të shtrirë gjatë gjithë vitit akademik 2021-2022.

Në kuadër të projektit “Studentët flasin” është zhvilluar në prill 2022 takimi me Avokaten e Popullit, Znj. Erinda Ballanca, ku përveç informimit për prioritetet e punës së institucionit të Avokatit të Popullit, studentët patën mundësi të bashkëbisedonin edhe për probleme konkrete dhe të prekshme që ata ndeshin gjatë jetës studentore, por jo vetëm.

Në kuadër të ndërkombëtarizimit dhe promovimit të Universitetit Barleti, studentët Barletas kanë pasur mundësinë e bashkëbisedimit të hapur dhe të drejtpërdrejtë në Forumin ARIO, në ambjentet e UniBa-s, me ambasadorë të akredituar në Tiranë, si dhe me drejtues të Institucioneve Ndërkombëtare që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vendin tonë. Ky aktivitet mujor ka filluar në shtator 2021 me takimin me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Znj. Yuri Kim, dhe ka vijuar rregullisht në tetor 2021 me ambasadorin e Suedisë, Znj. Elsa Håstad, në nëntor 2021 me ambasadorin e Austrisë, Z. Christian Steiner, në janar 2022 me ambasadorin e Slovenisë, Z. Peter Japelj, në shkurt 2022 me ambasadorin e Kosovës, Z. Skënder Durmishi, në mars 2022 me Ambasadorin e Italisë, Z. Fabrizio Bucci, si dhe me Drejtorin për Shqipërinë të Fondacionit “Konrad Adenauer”, Dr. Tobias Rüttershoff. Të gjitha këto takime synojnë një përfitim të dy-anshëm, si nga studentët ashtu edhe nga të ftuarit e nderit, për njohjen më të mirë të realitetit dhe aspiratave të rinisë shqiptare, por edhe të politikave dhe procedurave integruese dhe pritshmërive të komunitetit ndërkombëtar që punon dhe jeton në Shqipëri.



"BUSINESS ETIQUETTE" WORKSHOP ME ALUMNA GLADIN

Zyra "Alumni dhe Karriera", në bashkëpunim me Departamentin e "Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit" dhe Klubin e Karrierës, organizuan leksionin e hapur me temë: "Business Etiquette" me Alumna Gladi.

Workshopi u zhvillua më datë 21 dhjetor, tek Forum Theatre, gjatë orarit 11.30 - 12.30.

"Business Etiquette" është aftësia mbase më e rëndësishme që mund të kultivojë një sipërmarrës. Është mënyra se si sillemi përballë një bashkëpunëtori, klienti, stafi. Është arti i të sjellurit dhe komunikuarit për të dalë gjithmonë fitues. Gladi, është themeluese e Akademise së Mikpritjes dhe Turizmit (HAT). Ajo trajnon dhe këshillon Hotelierë të suksesshëm në kurset profesionale dhe konsulencat që ofron bashkë me skuadrën e saj, në Shqipëri dhe Kosovë. Mentor.al është sipërmarrja tjetër e Gladit. Ajo këshillon të rinjtë dhe të tjerë të rriten profesionalisht duke punuar në kompani të suksesshme. Workshopi u shoqërua me shumë pyetje dhe interes nga ana e studentëve.

Ju mirëpresim në takimet e radhës!



WORKSHOP MBI ORGANIZIMIN E EVENTEVE

Në 3.02.2022 Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit në vazhdim të akvitetëve, organizuan workshop-in "Rezervim, Planifikim dhe Menaxhim Event" me të ftuar Emerald Events & Décor.

Z.Endri Plaku, General Manager of Emerald Events & Décor paraqiti para studentëve rreth trendit dhe mënyrave se si rezervohet, organizohet dhe menaxhohet një event.

Barletasit dhe gjimnazistë nga Durrësi kishin mundësinë të ndiqnin disa këshilla nga sipërmarrës të rinj, por të suksesshëm në Industrinë e Eventeve, duke u njohur më nga afër me punën dhe kuriozitetet rreth kësaj industrie.



PANAIRI NDËRKOMBËTAR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

Departamenti i Turizmit, Mikpritjes dhe Rekreacionit në Universitetin Barleti mori pjesë në "Panairin Ndërkombëtar të Turizmit dhe Mjedisit", 2-4 Qershor në Expocity Albania.

Studentët e turizmit morën pjesë në konkursin mbi sfidat e turizmit në Shqipëri duke paraqitur para jurisë projektin e tyre mbi promovimin e destinacioneve turistike të panjohura.

Studentët e Klubit të Artit dhe Kulturës performuan me valle nga treva të ndryshme të Shqipërisë.



CEREMONIA E DIPLOMIMIT

Universiteti Sipërmarrës Barleti realizoi në Kampusin e Ri Universitar në një atmosferë të këndshme e entuziaste, ceremoninë e parë të diplomimit pas pandemisë.

Studentët u uruan dhe përshëndetën në këtë ditë të shënuar jo vetëm nga stafi akademik dhe prindërit, të afërmit e miqtë, por edhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit Znj. Evis Kushi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë Znj. Delina Ibrahimaj si dhe partnerë të Barletit, përfaqësues të botës së biznesit, akademisë e shoqërisë civile.

Studentët e diplomuar në ShkencaPolitike, Arkitekture, Informatike, Drejtësi, dhe Psikologji hyjnë në tregun e punës me karriera të zjedhura me dije profesionale, dhe me aftësi e cilësi të reja për tregun e punës në ndryshim të vazhdueshëm.

Diplomat e Barletasve janë gurë kilometrikë të rëndësishëm të përfundimit të një faze të jetës dhe të fillimit të sfidave të reja si profesioniste, lider, influencer, aktivist shoqëror e politikë etj. Universiteti Barleti me kurrikula të ndërkombëtarizuara e ndërdisiplinore aftëson studentët për karriera si brenda dhe jashtë vendit vlerësuar maksimalisht nga institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare të licensimit dhe akreditimit duke merituar plotësisht titullin "Universiteti #Sipërmarrës i Ekselencës".



Jo vetëm programet e studimit, por dhe stafi akademik me eksperiencë kombëtare dhe ndërkombëtare, në ambientet, me auditore e laboratorët bashkëkohore, ofron dhe një jetë të pasur studentore.

Hapja e programeve të reja dhe e Fakultetit të Shkencave Mjekësore si dhe kampusi i ri modern, janë arritjet më fundit të UniBa.

Ministrja e Arsimit theksoi në fjalën e saj, arritjet e Universitetit Barleti në përgjigje të sfidave të kohës në lidhje me kurrikulat dhe programet bashkëkohore.

Ndërsa Ministrja e Ekonomisë dhe Financës iu kujtoi studentëve që përshtatja ndaj ndryshimeve falë formimit dhe diplomës së fituar është tashmë pjesë e jetës dhe karrierës së tyre.

Tashmë Alumni të Universitetit Barleti do ndiqen nga Zyra "Alumni dhe Karriera" për projekte dhe bashkëpunime të vazhdueshme.



PANAIRI I PUNËS

Zyra e Karrierës në bashkëpunim me Klubin e Karrierës organizoi, datë 19.05.2022 Panairin e Punës në Universitetin Barleti.

Të gjithë Barletasit dhe Alumni/ae Barletas që ishin prezentë në panair u njohën me shumë mundësi internshipi, trajnimi dhe punësimi direkt nga kompanitë më në zë të tregut shqiptar dhe të huaj.

Me prezencën e kompanive të mirënjohura si: Deloitte, Sitel, Blue Filters, Abi Bank, Credins Bank, Easy Pay, Balkan Sport, Selecta, Joma Albania, Bio Check, Lab Check, Sigal, On Top, Junior Achievement dhe kompani të tjera që ofruan drejtpërdrejt mundësi punësimi dhe praktikash studentore për Barletasit dhe të diplomuarit tanë.

Për të gjithë të interesuarit që nuk mund të ishin pjesë në panair, Universiteti Barleti lidhi 10 marrëveshje bashkëpunimi me kompanitë për praktika pune dhe punësim të studentëve dhe Alumni/ae Barletas.



UNIBA MASTERCLASS ME DIZAJNER-EN E NJOHUR FRANCEZE, MATALI CRASSET

Në kuadër të Javës së kulturës franceze, Në 29.04.2022 në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, departamenti i Arkitekturës dhe Dizajnit në UniBa, organizoi dy ditë masterclass me dizajner franceze matali Crasset.

Matali Crasset është një nga figurat më interesante bashkëkohore në dizajn duke ndjekur një qasje eksperimentale dhe multidisiplinare në punën e saj.

Ajo prezantoi tek studentet projektet e saj, që shpesh kombinojnë zejtarinë, muzikën elektronike, arkitekturën dhe grafikën në një mënyrë transversale dhe dinamike.

Gjithashtu, nën kujdesin e saj studentët zhvilluan edhe një workshop ku pasqyruan mënyrën e tyre të përshtatjes me natyrën dhe territorin.



FAZA ÇEREKFINALE, DEBATI RINOR

Me 29.04.2022 u zhvillua faza çerekfinale e Programit Kombëtar të Debatit Rinor për Modelin e Zhvillimit Social dhe Ekonomik të Shqipërisë, të organizuar nga Scidev.

Në fazën çerekfinale studentët e Universitetit Barleti u përballën me studentët e Universitetit Mesdhetar.

Përballja ishte e fortë, me argumente të mbështetur në evidenca, me gjuhë të artikuluar dhe qëndrim korrekt.

Falenderim për studentët Jurgen Spaho, Koi Barbullushi, Klea Shqypi, Dritan Gjonaj me në krye mentoren e grupit zysh Eurona Leka.



FORUMI GAL

Më datë 2 Qershor 2022, Universiteti Barleti në kuadër të Forumit GAL, mirëpriti Ministrin e Drejtësisë z. Ulsi Manja.

Ministri zhvilloi një bisedë me studentët e pedagogë lidhur me reformën në drejtësi, reformën e sistemit gjyqësor dhe hartën e re të gjyqësorit, si dhe çështje që lidhen me integrimin e Shqipërisë në BE.

Biseda u zhvillua e ngrohtë dhe miqësore ku Ministri Manja iu përgjigj një interesimi të shtuar të studentëve dhe pedagogëve.

Zoti Manja foli hapur dhe pa doreza, duke theksuar pikat e dobëta dhe arritjet e reformës, duke sqaruar angazhimin e tij lidhur me hartën gjyqësore dhe kriteret e saj.

Zoti Manja u shpreh optimist lidhur me integrimin, duke theksuar rolin e rëndësishëm të ministrisë që ai drejton në këtë proces.

"Forumi GAL kishte të ftuarën e muajit Maj ministren e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale znj. Ogerta Manastriliu.

Bashkëbisedimi u zhvillua në formën e një debati publik ku studentët e pedagogët bënë pyetje e komentet e tyre në lidhje me sistemin shëndetësor. Znj. Manastriliu me thjeshtësinë dhe përgjegjshmërinë që e karakterizon iu përgjigj pyetjeve duke shpalosur njëherazi dhe strategjinë qeverisëse për vitet e ardhshme në një ndër sektorët më të rëndësishëm për vendin; shëndetësinë e përkujdesjen sociale"

Me 20 prill Forumi Gal e ftuar special Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Znj. Mirela Kumbaro.

Tema si Ndërgjegjësimi i të rinjve dhe jo vetëm, në ruajtjen e mjediseve të pastra, rendësia e ruajtjes së standarteve botërore të turizmit dhe hotelerisë, e shumë tema të tjera me shumë interes ndjekur nga Barletas, u diskutuan me Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit, Znj. Mirela Kumbaro.

Forumi GAL në janar zhvilloi takimin e rradhës me Ministrin e Brendshëm zotin Bledar Çuçi.

Gjatë këtij takimi Ministri shpalosi sfidat e tij dhe institucionit që ai drejton, në shërbim të publikut. Z Çuçi e vuri theksin në dy momente që i konsideron sfida për mirëqeverisjen e institucionit: dixhitalizimin dhe investimet në teknologji, (si nevojë jetike për modernizimin e sigurisë në vend) dhe Agjensinë e Mbikqyrjes Policore, si njësi civile e cila do të funksionojë sipas modeleve europiane.

Gjatë takimit u vu theksi në nevojën e një bashkëndimi sa më të frytshëm mes organeve qeverisëse dhe botës akademike, me synim arritjen e një mirëqeverisje dhe rritjen e zbatueshmërisë së ligjit!

Interesi i auditorit ishte i lartë, veçanërisht i studentëve.

Forumi GAL më 17.03.2022 organizoi takimin e

përmuajshëm me personalitetet më të larta drejtuese në vend.

I ftuari special ishte Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj i cili zhvilloi një bashkëbisedim të frytshëm, emocional e mjaft efektiv me studentët e UniBa.

Mes të tjerave biseda u përqëndrua në disa momente:

Nevoja për ta shndërruar çdo pengesë në një mundësi dhe qyteti i Tiranës këtë ka patur filozofi.

Nevoja për mbështetje të njëri tjetrit, duke përqafuar pa mllef çdo gjë pozitive të dikujt apo diçkaje që i shërben shoqërisë.

Nevojën për të mësuar sipërmarrjen dhe nevojën për tu marrë me politikë.

Studentët dëgjuan me shumë vëmendje dhe bënë pyetje e tyre rreth problematikave që i shqetësojnë.



SCIENCE FOR YOUTH

Konferenca Shkencore Ndërkombëtare "Science For Youth" mbledhi së bashku studiues shqiptarë dhe ndërkombëtarë nga fusha të ndryshme si: Psikologjia, Arsimi, Sporti dhe Mirëqenia, Arkitektura, Industri Kreative, Shkenca Kompjuterike, Ekonomia, Turizmi, Ligj dhe Shkenca Politike

Pandemia e Covid19 ishte dhe është ende një çështje kritike globale, duke prekur jo vetëm shëndetin dhe mirëqenien e popullsisë, por edhe arsimin, ekonominë, të drejtat e njeriut, politikën sociale etj.

Të rinjtë përfaqësojnë pjesën e popullsisë që do të preket veçanërisht nga sfidat, ndryshimet dhe inovacionet në të ardhmen e afërt.

"ScienceFor Youth" provokoi diskutime, rrjetëzim dhe synon krijimin e lidhjeve të qëndrueshme midis pjesëmarrësve.

Keynote Speakers, profesor të nderuar Prof. Tomasz Ochowski nga University of Warsaw, Prof. Ana Vivas nga CITY College, University of York Europe Campus dhe Prof. Antonio Labalestra, Prof. Vincenzo Paolo Bagnato Vinsbagnato nga Polytechnic University of Bari ishin një vlerë e shtuar e kësaj konference multidisiplinare në projekte kërkimore në fushat e Shëndetit Mendor dhe Edukimi, Sipërmarrja dhe Turizmi, Qeverisja dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm, Arkitekturë dhe Sport dhe Mirëqenie.

BOOTCAMP "HOLLY FACTORY"

Bootcamp "Holly Factory" bëri bashkë rreth maturante nga gjimnaze të ndryshme në Tiranë në një aktivitet dinamik që zgjati 8 orë.

Maturantët provuan veten në sfida të ndryshme siç është "Sfida Marshmallow", "Të gjenerosh një ide biznesi me 6 fjalë" ku vlerësuan njërin-tjetrin mbi prezantimet e bëra.

Një nga sesionet tipike tanimë të Bootcamp-eve është dhe biseda motivuese me prof. Rezart Prifti i cili këtë herë zgjodhi të fliste mbi rëndësinë e motivimit jo vetëm në sipërmarrje, por në çdo fushë tjetër.

Më pas maturantët punuan mbi idetë e tyre ku në total u prezantuan 8 ide të cilat synonin të zgjidhnin probleme të ndryshme të konsumatorëve ku anëtarët e 3 ideve fituese u shpërblyen me bursa të plota dhe të pjeshme pranë universitetit Barleti.



RËNDËSIA E BRANDIMIT

Departamenti i Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës organizoi me datë 2 Dhjetor leksionin e hapur "Rëndësia e brandimit në marketing/turizëm".

I ftuar ishte Agi Haxhimurati, themelues dhe drejtues i kompanisë Agi Haxhimurati LLC. Nëpërmjet paraqitjes së projekteve të realizuara si brandimi i Hotel van Bebbber, Bunk'art 1 & 2, Hardh Fest, Kalaja e Tiranës përcolli te audiencia, veçanërisht te studentët jo vetëm rëndësinë e brandimit por hapat që ndërmarrin marketierët për të realizuar projekte sa krijuese edhe efektive, dhe pse kjo është e rëndësishme. Gjithashtu u theksua se këto projekte kanë pasur një ndikim të konsiderueshëm në tërheqjen e turistëve, në rastin e projekteve të realizuara në Shqipëri.



SPRING ENTREPRENEURSHIP FORUM

Spring Entrepreneurship Forum mbledhi në Hotel Adriatik Durrës më 7 Maj, rreth 130 maturanët nga gjimnazet e Tiranës në një event dinamik dhe plot energji ku motoja ishte: Fuqizimi nëpërmjet dijes.

Forumi i hap nga profesor Erion Kristo i cili preku tema të ndryshme, si: Emigrimi i të rinjve jashtë vendit; Rëndësia e Sinergjisë ku dhe sesioni u mbyll me një ushtrim praktik mbi këtë temë.

Përmirësoni, mësoni dhe përparoni në nivele më të larta

Në pjesën e dytë të Spring Entrepreneurship Forum, prof. Erion Muca foli mbi Formulën dhe Skemat e Suksesit dhe Analfabetizmin Funkcional ku maturantët patën mundësinë të ndanin idetë nëpërmjet aktiviteteve si dhe konceptet e tyre mbi temën.

Forumi u përmbyll me energjinë pozitive dhe motivimin e prof. Rezart Prifti.

Mes humorit dhe bisedave interaktive me maturanët, profesori ndau mësimet të vlefshme dhe i motivoi ata të këmbëngulin dhe punojnë fort për të arritur atë që duan.

"Sometimes you just need a push, or a word, or some inspiration, or a jigsaw, or... The idea is that sometimes you just need something to push through" - thotë prof. Rezart Prifti.

"Të gjenerosh një ide biznesi me vetëm 5 fjalë" Kjo ishte sfida me të cilën u përballën maturantët në Spring Entrepreneurship Forum Empowering Through Knowledge Të ndarë në grupe, të mentoruar nga Prof. Rezart Prifti, dhe në limitin e vetëm 3 minutave ata propozuan zgjidhje nga më kreativitet, provë e një imagjinatë të gjallë dhe sjellje e orientuar drejt zgjidhjes së problemeve.



PANAIRI STEAM

Panairi STEAM ishte sukcesi tjetër i Universitetit Barleti.

Nxënësit e shkollave të mesme prezantuan projektet e tyre nga fusha të ndryshme si arkitekturë, inxhinieri, biologji, design, robotics, arte etj, gjithashtu u njohën me projektet e njeri-tjetrit, me profesorët e mirënjohur të komisionit, si dhe me fakultetet dhe programet që UniBa ofron.

Komisioni shpalli 10 projektet fituese të cilat do të marrin:

Një mundësi udhëtimi në Teknofest në Turqi;
Ulje në tarifat në programet që UniBa ofron.



TIRANA BARLETI BASKET SHPALL KAMPION

Në datë 05.02.2022 u zhvillua finalja e Kupës së Republikës Partizani- Tirana Barleti për basketboll femra.

Ekipi i Tirana Barleti Basket i Shoqata Barleti që përfaqëson Universitetin Barleti u shpall fitues duke dhuruar një spektakël të vërtetë.

Universitetit Barleti ju shtua edhe një trofe



SHQIPËRIA, NJË VEND PËR TU EKSPLORUAR!

Shpesh e ndjejmë veten tonë të lodhur nga stresi i përditshëm dhe dëshirojmë që të arratisemi diku, qoftë edhe me mendjen tonë për të gjetur qetësinë dhe paqen që për shkak të rrjedhës së jetës na mungon.

Menjëherë mendojmë për Durrësin, Vlorën,

Sarandën, Valbonën e Thethin e shumë destinacione që presin shumë vizitorë çdo ditë. Në këtë rubrikë ne studentët e Turizmit do ju sygjerojmë disa destinacione që patjetër në Shqipëri ja vlen për tu promovuar dhe vizituar.



LIQENET E LURËS

Liqenet e Lurës, një mrekulli që duhen vizituar! Një nga arsytet se përse na pëlqen kaq shumë të udhëtojmë është për shkak të krijimit të ndjesive të reja, që na bëjnë t'i rikthehemi natyrshëm fëmijërisë, atëherë kur bota ishte një e panjohur që duhej ta zbulonim. Këto emocione do të merrni dhe në Liqenet e Lurës, ku do përqafoheni nga një bukuri natyrore që do të doni ta përjetoni deri në fund. Janë plot 12 liqene që shtrihen në një lartësi 1600 m që zbukurojnë të gjithë Parkun Kombëtar të Lurës, ku ndër më të mëdhenjtë e më mbresëlënësit përmenden Liqeni i Madh, Liqeni i Zi, Liqeni i Luleve, Liqeni i Rrasave, Liqeni i Hotit etj.



PARKU KOMBËTAR NATYROR SHEBENIK JABLLANICË


Një nga arsytet se përse na pëlqen kaq shumë të udhëtojmë është për shkak të krijimit të ndjesive të reja, që na bëjnë t'i rikthehemi natyrshëm fëmijërisë, atëherë kur bota ishte një e panjohur që duhej ta zbulonim. Këto emocione do të merrni dhe në Liqenet e Lurës, ku do përqafoheni nga një bukuri natyrore që do të doni ta përjetoni deri në fund. Janë plot 12 liqene që shtrihen në një lartësi 1600 m që zbukurojnë të gjithë Parkun Kombëtar të Lurës, ku ndër më të mëdhenjtë e më mbresëlënësit përmenden Liqeni i Madh, Liqeni i Zi, Liqeni i Luleve, Liqeni i Rrasave, Liqeni i Hotit etj.



BASHTOVA

Ky monument historik dhe kulture ndodhet midis Kavajes dhe Rrogozhinës dhe mund të arrihet atje nga rruga kryesore (autostrada SH4) duke dalë në Gose dhe të vazhdoni udhëtimin drejt perëndimit për në fshatin Vile, ku edhe ndodhet kështjella, që distancohet rreth 12 km nga Gosa. Në alternativë mund të arrihen edhe nga plazhi i Grethit ose Spillesë ose edhe nga Divjaka, pasi kalaja ndodhet pikërisht midis këtyre plazheve rreth 1 km nga plazhi.

E vendosur anës Via Egnatia-s, njëres prej rrugëve kryesore që lidhnin lindjen dhe perëndimin gjatë Perandorisë Romake, Kalaja e Bashtovës ka tërhequr vëmendjen e popullit shqiptar dhe atij ndërkombëtar ndër shekuj. Vetëm disa kilometra larg Kavajës, kalaja më shumë se 500-vjeçare dëshmon për gjurmët e aqytetërimit dhe civilizimit në vend. Shpallur monument kulture i kategorisë së parë në vitet 1948 dhe 1971, Kalaja e Bashtovës është gjithashtu në listën tentative të UNESCO-s si Vend i Trashëgimisë Botërore.



QUKËS SHKUMBIN


Qukësi është një fshat i zonës së Librazhdit dhe bën pjesë në qarkun e Elbasanit. Qukës quhet fshati i cili emrin e ka marrë nga lumi Shkumbin. Fshati Qukës ndahet në dy zona Qukës Shkumbin dhe Qukës Skënderbe. Qukës Skënderbe është fshati i cili emrin e ka marrë fal legjendës së Skënderbeut. Gjenden shpella dhe sofra ku ka qëndruar Skënderbeu me trimat e tij. Po ashtu gjenden gjurmët ku kalon rruga "Egnatia".

"Dikur në kohët ku turqit po pushtonin tokat shqiptare, Skënderbeu me shpatën e tij madhështore preu shkëmbin e majës së malit dhe kështu ushtria e perandorisë osmane përfundoi nën greminë"

Fal kësaj legjende mali u quajt "Mali i Skënderbeut".

Në Qukës Shkumbin kalon rruga nacionale dhe po në këtë fshat ndodhet "Ura e Bushtricës" rreth 17 kilometra e gjatë e ndërtuar në vitin 1974. Një karakteristikë e këtij fshati janë dhe shinat e trenit, kur në kohët e mëparshme kalonte treni. Bukuria e fshatit favorizohet nga lumi i famshëm i cili ndan jugun dhe veriun e Shqipërisë. Njerëzit që banojnë në këtë fshat janë 2100 banorë. Diçka interesante që e bën këtë fshat antik janë tunelet të cilat kanë një arkitekturë unike. Një vizitë turistike do të ishte e veçantë, ku në dimër pemët dhe çdo gjë merr një peisazh të bardhë kurse në verë një peisazh të gjelbërt. Pasuritë natyrore që nëna natyrë i ka fal këtij vendi janë mbreslënëse.

Atraksione të Zbuluara



LUMI I GASHIT

Lumi i Gashit është një prej dy rezervateve natyrore shqiptare të përfshirë në listën e trashëgimisë botërore të natyrës të UNESCO-s. Me një sipërfaqe prej 3000 ha, lugina e Gashit gjendet në pellgun e parkut kombëtar të Valbonës, në verilindje të Alpeve, në rrethin e Tropojës, shumë larg zonës së banuar.

Një pjesë e madhe e sipërfaqes së Lumit të Gashit mbulohet me pyje të virgjëra ahu e këto pyje të lashta janë arsyeja pse Shqipëria i është bashkuar 12 vendeve të tjerë në listën e UNESCO-s. Kjo mrekulli natyrore ruan një nga natyrat më të paprekura në Shqipëri!



VARRET E SELCËS

Varret e Selcës gjenden 40 km larg Pogradecit, në zonën malore të Mokrës, në Selcën e Poshtme. Selca u themelua në shekullin e VI p.e.r, u fuqizua në shekullin IV-III. Selca ndodhet përgjatë rrugës Egnatia, që lidhte luginën e sipërme të Devollit me vendbanimet e kolonëve grekë. Në këtë sipërfaqe janë zbuluar 5 varre monumentale mbreslënëse, që i përkasin kësaj periudhe, të ndërtuara nga fundi i shekullit IV Katër nga këto varre janë gdhendur si tunele në shkëmb dhe njeri është i rrethuar me blloqe katërkëndore guri. Brendësia e varreve përbëhet prej një paradhome dhe dhomës së varrimit, me një shtrat prej guri për trupin dhe rafta për pajisjen e varrimit. Mbi varret është një shesh orkestre, për ceremonitë e varrimit. B.C të cilat janë unike në Evropë për nga aplikimi i tyre.



LAGUNA E NARTËS DHE ZVERNËCI

Laguna e Nartës përfaqëson një nat më të mëdha e më të rëndësishme Shqipërisë. Ajo ndodhet në skajin jugor të rrafshët Bregdetare, në afërsi të qytetit të Vlorës. Laguna e Nartës dhe Zverneci gjenden 14 kilometra larg qytetit të Vlorës, në veriperëndim të tij. Pamja e kësaj lagune mund të merret madje që në kodrinë e Kriporja deri sa mbërrihet në qendër të Vlorës përgjatë rrugës që vjen nga Zverneci, me ishullin e vogël të tij, 14 km larg nga Vlora, aty ku mbaron Sodës dhe fillon laguna e Nartës. Kështu krijon një ansambël shumë të natyror, me plot kontraste dhe ku gjëto harmoni bukuria me qetësinë e këmbësorëve.

GURIN E KAMJES

Guri i Kamjes është majë shkëmbore me 1461 m mbi nivelin e detit që ndodhet në midis Malësisë së Mokrës (rrethi i Pogradecit) dhe asaj të Gorës (rrethi i Korçës). Shkëmbinjtë ranorë, më të qëndrueshme gjërryerjes, i kanë shpëtuar sheshimisht ngritur mbi zonën përreth si një ishull cilin agjentët e ndryshëm atmosferikë (bora, era etj), kanë gdhendur forma të ndryshme mikroreleivi. Guri i Kamjes i ngjan një anijeje të madhe e cila vjen si pasojë e skalitjes dhe më tej vazhdueshëm nga erozioni. Është mrekthetë natyre.

PËR MË SHUMË DETAJE, DUHET TË SHKONI DHE TI VIZITONI EDHE JETËN

Ky ishte vetëm takimi i parë i eksplorimit të trashëgimisë natyrore dhe kulturore në Shqipëri.

Studentët e Menaxhimit të Turizmit dhe Rekreacionit dhe Eventeve

KRIJIMTARI


EDUKIMI DEMOKRATIK DHE QYTETARIA AKTIVE

Edukimi demokratik dhe qytetaria aktive janë dy terma të ndërlidhur me njëri-tjetrin që shpesh i gjejmë bashkë në një fjali, paragraf apo diskutim. Pa edukim demokratik nuk mund të kemi një qytetari aktive. Edukimi demokratik është një ideal arsimor që formon qytetari me vlera demokratike të aftë për të vendosur drejtësi, respekt dhe besim. Shpesh, edukimi demokratik, është emancipues me zërat e studentëve që janë të barabartë me ato të mësuesve dhe që ka në fokus edukimin e të rinjve me metoda demokratike të mësimdhënies. Këta të rinj përfshihen në jetën publike dhe çështjet që mund të shtrihen në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar duke formuar dhe duke u bërë pjesë e një qytetarie aktive.

Qytetarët aktiv janë ata që zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe të kuptuarit që të jenë në gjendje të marrin vendime pasi të jenë mirëinformuar dhe për të realizuar këtë ndihmon edukimi demokratik.

Qytetaria aktive në çdo vendim apo veprim që ndërmerret duhet të qendrojë brenda kufive të proceseve demokratike duke përfshirë këtu respektimin e demokracisë, drejtësisë, tolerancës dhe transparencës. Çdo individ mund të bëhet qytetar aktiv kur merr pjesë dhe vepron për interesat e përbashkëta dhe jo për qëllime a përfitimë monopolistike.

Përfundimisht, edukimi demokratik dhe qytetaria aktive varen nga njeri-tjetri. Një qytetari është aktive kur në bazën e saj qëndron edukimi demokratik, pra kemi të bëjmë me një qytetari demokratike të aftë për të kundërshtuar apo marrë vendime mbi bazën e parimeve të demokracisë. Një qytetari aktive e udhëhequr nga një edukim demokratik është vlera më e madhe e demokracisë.



Martine Prendi
MSH Edukim Fizik dhe Sporte,
viti I



Arkida Cara
Arkitekturë, viti I

VARFËRIA NUK KËRKON MËSHIRE

Brenda qënies njerëzore ushqehen ndjenja e emocione, qofshin këto plot jetë apo të zymta. Në shoqërinë tonë përballemi me njerëz të shtresave të ndryshme, njihemi me zjarrin përvëlues të mjerimit, që kudo ku shkel sjell errësirë e shpresa kërkohet vetëm me qiri. Vuajtja dallohet qartë në sytë e mbuluar nga manteli i skamjes që kërkon të zotëroje çdo gjë përreth. Fija e shpresës kërkon të mbahet gjallë, por nuk mundet në kembë të qëndrojë. E teksa rrugëve vështrohen zemra të plogështa që duket sikur lotojnë nga jashtë, të gjithë nxitojnë të nxjerin nga xhepi lakmitar para të shkoqura. A thua se jeta e tyre kështu do të rregullohet?! E kur dora paratë i zgjat gjithë krenari, një njeri thyhet në mijëra pjesë. Nuk është ky veprim që do të bëjë të ndihen më mirë. Skamja nuk ikën nëse është e rrënjësuar në shpirt, pasi varfëria shpirtërore rritet si një gjarpër që kërkon të ushqehet me shpirtin e "viktimit të tij". Varfëria nuk zgjedh, ajo i përllan grimcat e shpresës dhe i mbyll në kafazin e errësirës. Kufizon dëshirat që burojnë nga dashuria për jetën e i kthen ato në mallkime për të. E drejta qëndron aty e heshtur në një cep në sytë e shumëkujt, ndërsa në sytë e shumë të tjerëve ka kohë që ka vdekur. Lufta e vërtetë bëhet aty ku gjenden "eshtrat" e së drejtës, e nëse ato arrijnë të ngrihen nga hiri i tyre atëherë zjarri përvelues i varfërisë djeg vetveten. Kjo është e vetmja mënyrë që qiriri të mos fiket para se të gjejë fijen e artë të shpresës në errësirën e pafund.

ÇAST NGA ERRËSIRA VDEKJA

Lehtas rrëzohet posi
Vargjet në poezi.

Vaji i këngës përmaritar
Si ëndrra e të verbrit
harrohet.

Fatkeqësia dhe gëzimi
Nëpër rreshta s'pret por
harbohët.

E njeriu nga hidhërimi rrëmbyer
Herë vajton a kompozon
Dufin prej zemre
Që si valë deti çliron.



Fanila Belba
Arkitekturë,
viti I

DISA KËSHILLA PËR TË PËRMIRËSUAR JETËN TUAJ:

Koha është miku dhe armiku më i madh i njeriut, shfrytëzoni çdo mundësi.
Mos nxitoni të vraponi për të ardhmen, mos mbani mendjen tek e shkuara.
Vdesim një herë, por jetojmë çdo ditë.
Mos mbani mbi shpatulla ëndrrat e porealizuara të të tjerëve.
Mos krahasoni veten me njerëz të tjerë, jemi autentikë.
Respektoni kohën që ju duhet për tu rritur.
Tregohuni humane, të dhembshur me veten dhe të tjerët.
Mos neglizhoni shëndetin emocional.
Besoni në potencialin tuaj.



Artemisa Bajrami,
Informatikë e Aplikuar, viti II

KU E SHOHIN BARLETASIT VETEN NË TË ARDHMEN?

Marketingu është një koktejl imagjinate, iluzioni, inovacioni, identifikimi i nevojave, besnikërisë dhe matjes nën një prespektivë të globalizuar të hapur dhe të azhurnuar vazhdimisht. Në të ardhmen time synoj të jem pjesë e një platforme të tillë dhe të kem ndërtuar karrieren time si Analiste e Marketingut Dixhital. Duke studiuar zakonet dhe sjelljet e konsumatorëve do të jem në gjendje t'u vij në ndihmë organizatave për të njohur më mirë konsumatorët e tyre dhe padyshim do të ishte realizimi i një misioni siç është dhënia e një dore për të arritur audiencën e duhur qoftë nga bizneset e mëdha ashtu edhe ato të vogla.



Adelajda Daja
Marketing, Publicitet dhe
Marrëdhënie me Publikun, viti I

Duke qenë se prej vitesh merrem me sportin e karatesë, të ardhmen time e shoh në këtë fushë si pedagoge ose duke administruar palestren time.

Synimet e mia janë ende të larta, pasi dua të shpallm dhe kampione bote. Kjo është një punë që e bëj me pasion dhe vullnet të madh.



Sonja Bajramaj
Edukim Fizik dhe Sporte, viti I



Lorada Jemini
Arkitekturë, viti I

E shoh të ardhmen duke bërë atë që dua më shumë, të ushroj profesionin tim me pasion e vullnet. Kohën ta kaloj duke mbushur fletët me frymëzimet e momentit, pa u ndalur, e me një qëllim. Arkitektura më jep mundësinë të nxjerr në jetë idetë e mia dhe kjo më dhuron një ndjesi emocionuese. E përfytyroj veten në një studio të vogël, të sistemuar sipas stilit tim e me plot ngjyra, pothuajse si shtëpia ime e dytë. Të ushroj një profesion që do të më japi të ardhura por mbi të gjitha kënaqësi!

Secili prej nesh është pasqyruar me dije që në fillimet e tij. Të kesh vizion për një të ardhme të sigurt është gjëja më e rëndësishme për çdo student që vazhdon një arsim të lartë dhe të kualifikuar! Por të jesh Barletas është një hap më përpara, një të ardhme të sigurtë dhe pse jo në Universitetin Barlet! Të shohësh veten si një studente ekselente në programin ku përfaqëson dhe jo vetëm me një staf të kualifikuar pedagogesh ku ndihesh komode dhe e sigurt në atë çfarë ke zgjedhur! Pse jo, veten e shikoj të punësuar në Barlet!



Arishela Abdi
Drejtësi, viti II



Fakulteti i Shkencave Mjekësore

FARMACI

INFERMIERI

FIZIOTERAPI

Universiteti "Barleti" ka nënshkruar, në kuadër të hapjes së fakultetit të ri të Shkencave Mjekësore, protokollin e bashkëpunimit akademik, shkencor dhe praktik, me përfaqësuesit e Operatori Sanitari Asociati dhe HC Training.



Kjo marrëveshje mundëson organizimin e kurseve të trajnimit pasuniversitar në fushën e **infirmierisë**, me qëllim përditësimin e aftësive profesionale në standarde evropiane. Të diplomuarit në infirmieri pajisen me njohuri sa më bashkëkohore dhe kopetenca e aftësi që ju hapin rrugët si profesionistë.



Kursi 4 mujor do të zhvillohet në fundjavë pranë ambienteve të Universitetit "Barleti", si fillim nga stafi akademik e profesional italian, për 3 muaj, me programe të njehsuara me ato Italiane. Në muajin e katërt do të zhvillohet një praktikë pranë ambienteve të HC Training, në Romë si dhe pranë ambienteve të tjera ku OSA operon. Prej 35 vitesh OSA është një prej organizatave e cila operon në të gjithë shtetin fqinj duke asistuar në shërbimin mjekësor të klientëve në banesa, e **kjo nismë vjen për herë të parë dhe në Shqipëri.**



ÇFARË E DALLON QENDRËN YOUTHACT NGA GJITHË TË TJERËT?

'Youth Act' është qendër rinore e cila synon të fuqizojë rininë duke i dhënë atyre një rol aktiv për jetën e tyre, familjen dhe shoqërinë. Vizioni i kësaj qendre është fuqizimi i rinisë si promotori i zhvillimit të vendit duke mundësuar krijimin e një qendre në mbështetje të individëve, organizatave dhe iniciativave që kanë në fokus të tyre, të rinjtë shqiptar.

Ajo nga e cila dallon 'Youth Act' është ideja e cila e udhëheq, se të rinjtë janë e ardhmja e një vendi dhe duhet t'i jepet sa më shumë mundësi për të arritur suksesin në jetën e tyre.

Duke ditur rëndësinë e Kartës Rinore Evropiane në funksion të lëvizshmërisë rinore dhe pjesëmarrjes aktive, si dhe përdorimi i tyre si mjet për të promovuar politikën rinore, qendra 'Youth Act' ndërmori një proces të gjatë aplikimi për ta sjellë atë në Shqipëri.

Që prej muajit shkurt 2015, qendra 'Youth Act' është operuesja e vetme e kartës rinore evropiane në Shqipëri, si organizatë anëtare e 'European Youth Card Association', me seli në Bruksel.

Karta Rinore Evropiane është një rrjet me mbi 7 milion të rinj anëtar e cila ofron zbritje çmimi në 70.000 biznese në Shqipëri dhe 36 vende të Europës në: aktivitete të ndryshme kulturore, akomodim, udhëtime, argëtimin e të rinjve, trajnime e studime, sektorin shëndetësor, sektorin bankar, në turizëm, telekomunikacion dhe internet, turizëm, sport, etj. Të rinjve shqiptarë i ofrohen të njëjta përfitime si bashkëmoshatarët e tyre në Evropë e më gjerë. Gjithashtu, kjo kartë shërben si një mjet për të përcjellë informacion të përditësuar lidhur me mundësitë e trajnimit,

edukimit, bursave, vullnetarizmit, shkëmbimit të eksperiencave rinore brenda dhe jashtë vendit. Aplikimi bëhet 'online' në faqen: www.karta-rinore.al.

Qendra 'Youth Act' ofron mundësi aktivizimi për të rinjtë duke i bërë ata pjesë e projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, duke i krijuar atyre më shumë mundësi për të ardhmen.

'Youth Act' ka disa histori suksesi me të rinjtë të cilët kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme kudo në vende si: Angli, Spanjë, Turqi, Slloveni, Greqi, Helsinki, Bruksel, Serbi etj. Nëse jeni në dyshime se çfarë duhet të bëni për të ardhmen tuaj dhe se si të jeni më aktiv, atëherë sapo e mësuat një prej zgjedhjeve më të zgjuara që mund të bëni.



Adresa:

Rruga Frang Bardhi, Tiranë

Cel: +355 69 20 62 086 +355 69 20 41 222 +355 69 20 67 247

E-mail: info@umb.edu.al mastersecretary@umb.edu.al

admissions@umb.edu.al

Web: www.umb.edu.al

